

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017 PËR PROJEKTIN “ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I ZONAVE RURALE””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Vazhdimi i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me qëllim kontributin e mëtejshëm në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke forcuar e thelluar këto marrëdhënie nëpërmjet bashkëpunimit financiar përbën qëllimin kryesor të kësaj marrëveshjeje, duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr.294/2017).

Projekti “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” ka si objektiv të ofrojë shërbime në personel dhe materiale si dhe kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me vendimin nr.739, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, është vendosur miratimi në parim i marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”.

Arritja e finalizimit të këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë, në kuadrin e bashkëpunimit teknik si partnerë. Ky bashkëpunim do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në kuadër të shërbimeve dhe mbështetjes

teknike. Në zbatim të marrëveshjes gjermano-shqiptare, të datës 21 tetor 1988 mbi bashkëpunimin teknik, do të mbështetet projekti, “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t’u mbështetur. Në kuadër të këtij projekti, Republikës të Shqipërisë do t’i vihen në dispozicion shërbime në personel dhe materiale si dhe, eventualisht, kontribute financimi (grante) me një vlerë të prej 2 000 000 (dy milionë) euro.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, si dhe kujdeset për kryerjen e shërbimeve të nevojshme nga institucionet e ngarkuara për zbatimin e tij.

Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje paraqet interes në aspektin ekonomik e social, duke marrë në konsideratë nevojën për zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale të Republikës të Shqipërisë si dhe rëndësinë e mbështetjes teknike, në këtë kuadër.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunim teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” konsiston në përdorimin e shumës së financimit, në vlerë të përgjithshme prej 2 000 000 eurosh, si dhe kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo.

Premtimi financiar për projektin e bashkëpunimit teknik si dhe shuma përkatëse do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda 4 viteve, pas vitit të premtimit financiar, nuk janë lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit si dhe, eventualisht, kontrata e financimit. Për këtë shumë afati përfundon në datën 31 dhjetor 2021.

Përfituesi do të jetë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe përfituesi final do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Hollësitat e projektit si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar ose do të ngarkohen me zbatimin e projektit. Kjo marrëveshje vlen si për projektin përkatës ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej projektin. Për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes të datës 21 tetor 1988, lidhur ndërmjet dy qeverive tona, për bashkëpunimin teknik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës.

Procedura është në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji për bashkëpunim teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” nuk ka përafrim me acquis e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2017 “Për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale””.

Marrëveshja është e organizuar në 5 nene, me specifikimet përkatëse.

Në nenin 1 parashtrohet se në zbatim të marrëveshjes gjermano-shqiptare, të datës 21 tetor 1988 mbi bashkëpunimin teknik, do të mbështetet projekti, “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t’u mbështetur. Në këtë kuadër, qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion shërbime në personel dhe materiale, si dhe, eventualisht, kontribute financimi (grante) me një vlerë të prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ngarkon për zbatimin e projektit shoqërinë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ GmbH*). Theksohet se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vehte, që të sigurojë, kështu, zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në pikën 1 dhe kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin.

Premtimi financiar për projektin e bashkëpunimit teknik, të përmendur në paragrafin 1, dhe shumën e përmendur në pikën 2 do të zhvlerësohet pa kompensim në rast se brenda 4 viteve, pas vitit të premtimit financiar, nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit, përmendur në pikën 2 dhe, eventualisht, kontrata e financimit. Për këtë shumë afati përfundon me mbarimin në datën 31 dhjetor 2021. Nëse kontratat e zbatimit dhe të financimit lidhen brenda afateve të parashikuara vetëm për një pjesë të premtimit financiar,

atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Në nenin 2 shpjegohet se detajet e projektit, të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve, që janë ngarkuar ose do të ngarkohen me zbatimin e projektit në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe të financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Në nenin 3 sqarohet se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 me porosi dhe me shpenzimet e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

Po ashtu, theksohet se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit, të përmendura në nenin 2.

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimbursen, me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane, vlerën e TVSh-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe të financimit, të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin të mbajtura në këtë kontekst merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e të dyja vendeve tona do të duan të mbështesin më tej projektin. Premtimet financiare të qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit, të përmendura në nenin 1, të paragrafit 1, bëhen të ditura nëpërmjet njoftimesh zyrtare nga ana e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

Në nenin 4 shpjegon se edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, të datës 21 tetor 1988, lidhur ndërmjet dy qeverive tona mbi bashkëpunimin teknik.

Në nenin 5, i cili është neni përmbyllës i marrëveshjes, shpjegohet se kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit. Sqarojmë se kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi përmbushen në momentin kur zbatohen të gjitha parashikimet e nenit 31, të ligjit nr.43/2016.

Paragrafi i dytë sqaron se kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike, në çdo kohë. Shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës. Paragrafi i tretë thekson se palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje. Në vijim, paragrafi i katërt shpjegon se mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptimin ndërmjet palëve përmes bisedash apo negociatash.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e marrëveshjes ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektmarrëveshja është propozuar nga Ambasada e Republikës Federale Gjermane. Struktura përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përgatitur projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së (rreth 200 000 euro), brenda buxhetit të miratuar të MBZHR-së.

KËSHILLI I MINISTRAVE